



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

### **Procesverbali i diskutimit publik për propozim rregulloren për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve**

Të martën me 22.03.2022 nga ora 16:00, u mbajt diskutim publik në sallën e mbledhjeve të kuvendit. Diskutimin e hapi drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke ju uruar mirëseardhje pjesëmarrëseve dhe duke i falënderuar për kohën që kanë gjetur për këtë diskutim publik. Drejtori Osmani para të pranishmëve prezantoi drejtorin e drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Fatmir Rudarin dhe drejtorin e drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahun.

“Komuna e Podujevës deri tani ka qenë duke operuar me një rregullore të aprovuar në vitin 2012, dhe me një pajtueshmëri të gjithëve duke konsideruar që është një rregullore e tejkaluar, vlerësuam që kjo rregullore duhet të plotësohet dhe të ndryshohet në mënyrë që të kemi një rregullore e cila parasheh procedurat dhe kriteret të drejta për ndarjen e subvencioneve.

Për rregulloren të cilën ju kemi ftuar në diskutim është caktuar një grup punues, i cili është marr me hartimin e këtij drafti rregullues. Siç e parasheh ligji rregullorja është aprovu si draft-rregullore në asamble komunale, mirëpo një muaj është në dëgjim publik në mënyrë që të diskutohet me grupet e interesit për këtë rregullore në mënyrë që kur të aprovohet në fund të jetë sa më e plotësuar. Që nga 4 marsi kur është aprovuar kjo rregullore deri më 4 prill jemi të hapur për sygjerimet dhe propozimet e juaja nga të gjithë sektorët. Kjo rregullore rrjedhimisht i përfshin të gjithë sektorët në të cilat subvencionon komuna e Podujevës, duke filluar nga arsimit ku subvencionohen studentët me bursa, pastaj sporti, kultura, bujqësia, shëndetësia dhe rrjedhimisht kjo rregullore përcakton edhe subvencionimet të cilat i ndan drejtoria e Shërbimeve Publike për hjekën e shpenzimeve të varrimit për personat e vdekur dhe subvencione të tjera të cilat ndahen nga komuna e Podujevës. Dihet që nga vet fjala subvencion janë mjetet që komuna e Podujevës i ndan pa kthim për subjekte të ndryshme, organizata qeveritare, bujq, studentë etj. Sot do të flasim vetëm për kriteret për ndarjen e subvencioneve, sigurisht që temë e debatit gjithmonë janë shumat të cilat ndahen për kategori dhe programe të ndryshme, ta zëmë gjithmonë ekzistojnë kritikën me të drejtë për shumën buxhetore që ndahet për subvencione për sport, kulturë, bursa dhe sigurisht kufizimet që janë në bujqësi dhe shëndetësi. Por kjo është temë tjetër, kur i kemi debatet publike për çështjet e buxhetit, ndarjet buxhetore kur aprovohet buxheti i komunës së Podujevës, aty përcaktohen mjetet buxhetore se sa mjete buxhetore do të ndahen për secilën kategori. Sot është debati vetëm për kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, besoj që pjesa dërmuese keni qenë të informuar me rregulloren e kaluar me të cilën janë ndarë subvencionet, kjo rregullore ka qenë edhe e publikuar si draft rregullore në faqen zyrtare të komunës pastaj ju mund t'i jepni propozimet e juaja lidhur me kriteret për ndarjen e subvencioneve, ne jemi të hapur për çdo propozim të juajin për çdo fushë të cilës i takoni, por mund të jepni propozime edhe në fushat tjera, propozimet mund t'i jepni këtu me diskutimet e juaja por mund t'i bëni edhe me shkrim, qoftë përmes sportelit apo përmes emailit që e keni në njoftim në faqen zyrtare. Tani ne nuk do ta zgjasim më shumë por do t'i marrim propozimet tuaja

për këtë edhe jemi mbledhur, ne vetëm deshtëm të japim një sqarim të përgjithshëm lidhur me rregulloren në fjalë”, tha drejtori Osmani.

Naime Podvorica- Me vjen mirë që ketu jemi me disa përfaqësuese që kemi qenë edhe pjesëmarrëse në disa trajnime me Partners Kosova dhe me disa organizata tjera.

Deshta me u informuar a është fjala vetëm për subvencionimin psh, regjistrimi i pronës në emer të dy bashkëshortëve, sa kishim pas mundësi me inkorporu edhe në këtë drejtim nga drejtoria për Kadastër dhe Pronë, që edhe këto të subvencionohen dhe të bëhet regjistrimi dhe të stimulohen gratë që të regjistrojnë pronën në emër të tyre, a munden me pas gratë përkrahjen në këtë fushë ?

Drejtori Osmani: Ju lutem të specifikoni për cilën fushë e keni fjalën sepse ka fusha të ndryshme.

Naime Podvorica: Siç e thash edhe më herët, sa mundemi në këtë fushë me i inkorporu gratë dhe sa mundeni me i përkrah?

Drejtori Osmani: Vetëm deshta propozimin konkret në cilën fushë sepse pastaj shqyrtohet mundësia, këto janë çështje procedurale që rregullohen nga drejtoria e Kadastrit.

Gazmend Havolli: Përfaqësues i klubit të karatesë “Llapi” një prej klubeve më të vjetra sportive në komunën e Podujevës.

Draft rregulloren për subvencionim nuk e kemi pa, mendoj që ky takim është shumë i rëndësishëm por nuk besoj që do të jetë i vetmi që do të mund të përcaktohet që sot mund të vendoset që të dal një rregullore më e mirë apo të mund të vendosen kritere.

Fillimisht isha ndal te formularët me të cilët aplikojnë klubet sportive nga thirrjet e drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ata formular janë më shumë për korporata apo për firma të ndryshme biznese sesa për ojq, janë mjaft të komplikuar dhe shumë klube kanë patur probleme gjatë plotësimit për shkak të kompleksitetit të tyre, janë shumë të paqartë, mendoj kur është fjala për klube sportive duhet të thjeshtohet gjuha, sepse shumica e pjestarëve përfaqësuese të klubit nuk kanë shumë njohuri ekonomike dhe të gjuhës së kontabilitetit, ka terma të cilët janë të panjohur dhe mundësia e klubeve për të angazhuar një kontabilist për të ndihmuar në ndihmën rreth sqarimit të formularit dhe plotësimit janë shumë të vogla. Pra, këto dy çështje deshta t'i ngris që draft rregulloren po flas për veti dhe për kologët që që vinë nga sporti i karatesë nuk i kemi lexu dhe nuk i dim cka përmban kjo rregullore dhe thjeshtimi i formularëve duhet të bëhet.

Fatlum Osmani: Draft Rregullorja është e publikuar në faqen e komunës, por mund të vini dhe ta merrni edhe fizike në drejtorin e Financave.

Agron Gërguri- Përshëndet të pranishmit, duke parë draftin dhe duke parë mënyrën e shpërndarjes së subvencioneve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, deshta të saktësohen disa gjera sepse është shumë e nevojshme. Citim i rregullores “ ...komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë por duke mos u kufizuar për...” cka nënkupton ky moskufizimi ? Nënkupton mos kufizim të shumës apo i veprimtarive apo dicka tjetër..!

Pastaj pika 1.4 thotë: citim rregullore “..shoqëritë amatore” nuk ka më emërtime të tilla, duhet të largohen prej emërtimeve amator apo profesionist, duhet të jetë vetëm shoqatë apo klube

muzikore, pastaj këtu kemi prap më poshtë teatri amator, edhe kjo duhet të largohet, duhet të thuhet “shfaqje teatrore”, apo skena e pavarur teatrore. Pastaj festivalet, kjo është kogja e përgjithshme, mund të ketë festival teatrore, muzikor apo tjetër botimi i librave, ekspozita, duhet të ketë performance artisitike dhe instalacione, janë dy veprimtari të cilat në kohën moderne janë shumë të shfaqura, këto duhet të mbështeten, pastaj turizmi kulturor një veprimtari shumë interesante që ka të bëjë edhe me artin edhe me veprimtari të ndryshme, trashëgimia kulturore që mungon dhe krijimi dhe zhvillimi i filmave të shkurtër artistik. Ndoshta do të duhej definuar edhe shumat për fushat e caktuara. Si dhe të evitohen dokumentet në fazën e aplikimit, sepse është shumë ngarkesë.

Drejtori Osmani: Sqarim: Kur bëhet thirrja publike, nëse ekziston interesimi me u shpall edhe për ato fusha përfshihen edhe gjatë thirrjes publike, ideja është që duke përfshirë por duke mos u kufizuar në mënyrë që rregullorja nuk mund çdo vit të rishiqohet, do të jetë për një periudhë më afatgjatë, dhe sigurisht që pas tri viteve përfshihet që duhet të mbështet një fushë e caktuar si filmi, kjo rregullore nuk të kufizon që ti me përfshish edhe filmin. Faleminderit për vërejtjet lidhur me terminologjinë besoj që do të punohet edhe në këtë drejtim.

Shumat buxhetore për çdo vit buxheti i përcakton ato, rrjedhimisht ne nuk mundemi t'i përkufizojmë ato shuma sepse kjo rregullore mund të jetë për 10 vite apo më shumë, ndërkohë që buxheti është çdo vit.

Rafif Muçolli: Përsëritet të gjithë të pranishmit dhe i përgaëzon për plotësimin dhe ndryshimin e kësaj rregullorje. Jam në cilësinë e përfaqësuesit të bletarëve “Llapi” nga Podujeva.

Komuna e Podujevës ka vite që e ka subvencionuar edhe këtë nënsektor dhe ka bërë mirë sepse e ka fuqizuar shumë, sot nëse mirret numri i zgjojeve në Republikën e Kosovës, komuna e Podujevës është me numrin më të madh, ndër të parat. Mirëpo këtë proces e kanë përcjellur edhe disa mangësi kështu që në procedurat vijuese duhet eliminuar për të qenë më të suksesshëm. Nga vitit 2012 është subvencionuar ky nënsektor, vazhdimisht kanë përfituar një numër i njëjtë që unë po i quaj recidivist, është mirë ta keni parasysh këtë element që të mos përsëritet më.

Kemi vërejtur që përfituesit janë të papërgaditur pa njohuri elementare si teorike ashtu edhe praktike për mbashtrimin e bletës dhe kjo i dërgon në dështim.

Propozojmë që në raste të tilla të përgaditën përfituesit më njohuri teorike dhe praktike së paku me 5 ligjërata, 4 prej tyre teori dhe 1 praktikë. Vonesat gjithashtu janë një nga problemet që kanë dhënë efekte negative.

Kriter kish qenë mirë më qenë përparsia e viseve të thella rurale dhe brezit kufitar, gjithashtu përparsi me pas gjinia femërore. Të ketë më shumë monitorim për punën dhe efektin e subvencionimit.

Gëzim Kiçmari: Jam nga sektori i fermerëve, jam i interesuar të di më shumë për kriteret e komunës tonë për Bujqësi, më konkretisht?

Drejtori Osmani: Arsyeja e ndryshim -plotësimit të kësaj rregullorje është mungesa e kriterëve të matshme numerike kur bëhet thirrja publike. Te neni 21 janë kriteret specifike të detajuara me

poentim numerik të cilat duhet të publikohen në thirrjen dhe ftesën për aplikim të përpilohen nga drejtoria përkatëse. Nga momenti kur aprovohet kjo rregullore çdo thirrje publike kur bëhet do të jenë kriteret numerike, varësisht prej thirrjes do të ndyrshojnë edhe kriteret numerike.

Psh: për bletari tu jepet përparësi zonës malore, për serra zonën fushore.. në bazë të politikave zhvillimore të përcaktohen kriteret numerike, dhe ky fakt e garanton transparencën.

Fatmir Rudari-drejtori i Bujqësisë, përshëndet të pranishmit dhe i përgjigjet Gëzim Kiçmarit. Aq sa kuptova ju e keni fjalën për grante të Ministrisë, ato i përcakton ministria këtu jemi diskutuar për subvencionime të komunës, varësisht prej kategorisë së subvencionimit bëhen edhe kritret siç tha edhe drejtori Osmani.

Gazmend Havolli: Zakonisht kur bëhen shpalljet publike ato e kanë afatin e caktuar për aplikim, pse asnjëherë nuk përcaktohet edhe afati për shqyrtim dhe për transfer të mjeteve? Nga fusha që përfaqësoj une fillojmë aktivitetet shumë herët dhe procedurat për subvencionim janë shumë të vonshme.

Rekomandimi im është të caktohen disa afate të aplikimit më të hershme por edhe vendimet të merren më heret, jo më vonë se java e parë e marsit.

Drejtori Osmani: Është shumë e vërtet që periudhat kohore janë të rëndësishme për këto fusha, këtë vit thirrjet janë hapur në muajin shkurt, më herët sesa vitet e kaluara, por sa i përket shqyrtimit është i rregulluar edhe me ligje të tjera që brenda 30 ditësh të vlerësohen aplikacionet nga dita e mbylljes së afatit të thirrjes.

Gëzim Kiçmari: Pyetje për drejtorin e Bujqësisë, a do të na përkrahni me subvencione siç përkrah komuna e Prishtinës për kokë lope ?

Fatmir Rudari- Ne jemi duke diskutuar për rregulloren e komunës së Podujevës, ne subvencionojmë vetëm me krerë lope, shumë shpejt do të hapet thirrja.

Fatlum Osmani: Ne ju presim deri më 4 prill për gjitha sygjerimet dhe propozimet e juaja, sigurisht këto që i dhatë këtu ne i evidentuam, do të angazhohemi maksimalisht që të bëjmë më të mirën, ideja e kësaj qëndron në radhë të parë të rrisim transparencën por edhe të vendosim kritere të drejta për ndarjen e këtyre subvencioneve.

Komuna e Podujevës si çdo organizatë tjetër është e kufizuar në shumën buxhetore, te shuma e subvencioneve e kemi një rritje nga viti i kaluar për 200 mijë euro, kemi bërë përpjekje qoftë për bursa të studentëve, qoftë në shëndetësi apo ndonjë fushë tjetër. Për këtë vit kemi 960 mijë euro, por shpresojmë që në vitet e ardhshme të kemi një rritje të buxhetit në komunë dhe sigurisht pastaj do të kemi edhe rritje të subvencioneve. Shkruani të gjitha vërejtjet e juaja dhe propozimet për të gjitha fushat dhe ne do t'i trajtojmë, jemi të hapur dhe bashkëpunës për këtë çështje.

Faleminderit secilit për kontributin tuaj! Mirë u pafshim!

22.03.2022  
Podujevë



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrëseve në dëgjimin publik të Propozim Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Mosha	Nënshkrimi
1	Nuime Podvorica	Podujevë	54	
2	Gomimete Sejdiu	Podujevë	51	
3	Kadime Kamenolli	Blloku	58	
4	AVINI IMERI	Podujevë	48	
5	NAJMA MURATI	PODUJEVE	52	
6	Ismet Oraca	Podujevo	1965	
7	Isak Curri	LLUGË	1978	
8	GAZMEND HAVOLLI	PODUJEVE	58	
9	IRFAN SFEÇLA	SFEÇEL	1976	
10	GEZIM STATOVCI	AEROKLUBI LLAPË	1974	
11	LUMBARDH SHALA	PODUJEVE	41	
12	FUAD HAZIRI	PODUJEVE	30	
13	FEIM SOPA	LETANC	44	
14	Driton Prabhani	LIADOC	50	
15	VJER MUSA	PODUJEVE	60	
16	GANI HAMZA	PODUJEVE	68	
17	Agon Gjergji	Podujevo		
18	SHENSI AJVAZI	LLAUSHË	37	
19	JETULLAH BERISHA	KONUSHICC	36	
20	SIKENDER REXHEPI	BRIJIN	33	
21	GANI ZUKA	ORIHAT	51	
22	MILJE MONOLLI	RETE	25	
23	Veohat Mujoll	Podujeve	33	
24				



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrëseve në dëgjimin publik të Propozim Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Mosha	Nënshkrimi
1	BEGIR UKA	DYR	52	
2	Gzim KICMARI	L'ADDFC	42	
3	MUHAMET SHATHOLI	BIADOC	28	
4	Mehmet Qasim	Shkup	—	
5	Xhafer Mustafa	GLLAMNIK	66	
6	SHENSI QERIMI	SIDR'EC	59	
7	Fëlim Mehmeti	Dumniceqme	44	
8	Rafiq Mucoli	Herice	70	
9	BLERIM RRAHMANI	DUMNICEVIT	42	
10	REXHEP MURRI	SIBOFC		
11	MALIQ MEHMETI	BURIC	45	
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				